



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep.	DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	03-02/2802/17
Data Datum Date	27-09-2017
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.09.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-828/17 për z. Hilmi Jashari – Avokati i Popullit, për shkak se nuk ka prova që dëshmojnë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-828/17 për Zyrtarin e lartë, z. Hilmi Jashari-Avokat i Popullit, ka qenë një pretendim nga pala e tretë me dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik. Dyshimi për situatë të konfliktit të interesit, sipas deklarimeve të denoncuesit, ka të bëjë me njërin nga pesë anëtarët e emëruar për Komisionin “Ad-Hoc” për vlerësimin e konkurrentëve për pozitën e Zëvendës avokatit të popullit.

Për të hetuar këtë rast në detaje, fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z. Hilmi Jashari. Më pastaj, në takime me zyrtarët e Agjencisë, ai është njoftuar me situatën për të cilën dyshohet, janë vërtetuar disa nga argumentet e paraqitura, është pyetur për procesin e konkurrimit dhe gjithashtu për anën ligjore të përgjegjësive dhe kompetencave që ka Avokati i popullit në lidhje me krijimin e këtij komisioni.

Sipas të gjitha argumenteve të paraqitura dhe provave të mbledhura për rastin, Agjencia kundër Korrupsionit ka konstatuar se të qenurit dikur e z. Jashari si Anëtar i Bordit të Organizatës Qeveritare “CiviKos”, në kohën kur Kryeshefe Ekzekutive e saj ka qenë zonja Valdete Idrizi, edhe nëse duket, faktikisht emërimi tash i zonjës Idrizi për Anëtare të Komisionit për vlerësimin e kandidatëve për Zëvendës Avokat të Popullit, nuk përbën konflikt faktik të interesit. Kjo “lidhje” për të cilën denoncuesi dyshon dhe e cilëson si “konflikt interesi”, është vetëm mbi baza profesionale e në asnjë rast lidhje familjare ose lidhje tjetër që të konsiderohet konflikt faktik i interesit.



D.m.th. edhe nëse për dikë mund të duket, në realitet emërimi i zonjës Idrizi për Anëtare të Komisionit vlerësues të kandidatëve nuk paraqet konflikt faktik të interesit. Ajo është emëruar krejtësisht sipas dispozitave që e autorizojnë Avokatin e popullit për krijimin e këtij Komisioni.

Konkretisht ky proces ka rrjedhur duke respektuar Ligjin për Avokatin e popullit, Nr.05/L-019, Neni 10 paragrafët 2, 3, 4, 5, që flasin për procedurën për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të popullit, si dhe Rregullorja për Mënyrën e konkurrimit, Procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për Zëvendës të Avokatit të popullit nr.01/2015, konkretisht Neni 4 që flet për Komisionin për rekrutim dhe intervistim. Në paragrafin 1 të këtij neni shprehimisht thuhet: *"Avokati i Popullit, me vendim, formon Komisionin për rekrutim dhe intervistimin e kandidatëve për zëvendësit e Avokatit të popullit"*.

Brenda këtyre parimeve ka vepruar edhe Avokati i Popullit. Megjithatë në takim z.Jashari i është rikujtuar edhe një herë se përkundër kësaj të drejte ai ne te ardhmen nuk duhet të krijoj komisione me anëtar me të cilët ka ndonjë lidhje të paraparë ne ligjin nr.04/L-051 e që mund të cilësohet si konflikt i interesit. Avokati i Popullit ka deklaruar se po të kishte një gjë të tillë do ta deklaronte, në fakt nuk do të krijonte komision me situatë të konfliktit të interesit dhe për çdo dyshim eventual për situata të tilla ai do t'i adresoj Agjencisë kundër Korrupsion për të marr vlerësimin e saj. Prandaj nga këto që u than me lartë si dhe në bazë të shqyrtimit të fakteve që kemi pasur ne dispozicion lidhur me këtë rast kemi arritur në përfundim dhe kemi konstatuar se nuk qëndrojnë pretendimet e palës denoncuese të përmendura në ankesën e dërguar në AKK-ë, duke aluduar në shkeljen e nenit 7 paragrafi 1 si dhe nenit 3 paragrafit 1.2. të Ligjit nr.04/L-051. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

